



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

**LEGJISLATURA V**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**  
Mbledhja nr. 44  
Prishtinë, më 14.9.2016, ora 11,00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Emilija Rexhepi, Sergjan Popović, Salih Salihu, Haxhi Shala, Shaip Muja.  
Munguan: përfaqësuesi i AAK-së, i cili ka dhënë dorëheqje.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë, sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 9.8.2016;
3. Shqyrtimi i çështjes së banorëve të zhvendosur të fshatit Hade;
4. Shqyrtimi i sëmundjes gungore të gjedhëve,
5. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje, u miratua pa vërejtje.

### 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 9.8.2016

Procesverbali i datës 9.8.2016, u miratua pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi i çështjes së banorëve të zhvendosur të fshatit Hade

**Kryesuesja**, lidhur me problematikën e zhvendosjes së banorëve të fshatit Hade, prezantoi të ftuarit në mbledhje: **z. Arben Çitaku**, sekretar i MMPH-së, **z.Xhafer Gashi**, kryetar i Komunës së Obiliqit, **z. Hilmi Jashari**, avokat i Popullit, **z. Arben Gjokaj**, drejtor i KEK-ut, **znj. Dajana Berisha**, drejtore e Forumit për Iniciativë Qytetare (FIQ) dhe **banorë të fshatit Hade**. Fillimisht, fjalën ia dha znj. Dajana Berisha.

**Dajana Berisha**, theksoi se Forumi për Iniciativën Qytetare është një fondacion që punon në terren me qytetarët, përkrah dhe mbështet çdo iniciativë qytetare që mbron të drejtat e qytetarëve, për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie prej çdo niveli qeverisës dhe institucioneve ndërkombëtare zhvillimore.

Në vitin 2011, Qeveria e Kosovës, zyrtarisht ka miratuar Kornizën ligjore për zhvendosje të Mijes së re, një dokument ky, që sipas deklaratave të zyrtarëve të Qeverisë, është në përputhje me standardet ndërkombëtare për zhvendosje. Megjithatë, duke i parë të gjitha problemet e jashtëzakonshme, me të cilat përballen banorët e Hades, qysh prej 2004, vitit të turpshëm të zhvendosjeve të dhunshme të banorëve me forca policore, Konsorciumi i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, KOSID, anëtar i të cilit është FIQ, e kontrakttoi dr. Ted Downing, president i Rrjetit Ndërkombëtar për Zhvendosje, ish-punonjës i Bankës Botërore, i cili mbasi vizitoi Kosovën dhe realizoi takime e intervista me të gjithë aktorët relevantë, e hartoi raportin e vlerësimit të zhvendosjes së banorëve të Hades për risistemim jovullnetar, për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre me procedurat operacionale të Bankës Botërore (OP 4.12, PS5, PR5, OECD dhe Parimet e Ekuadorit).

Raporti i Ted Downing, konstaton se ka një kontradiktë të jashtëzakonshme në mes kornizës së politikës për zhvendosje dhe një planit të mirëfilltë për zhvendosje.

- Korniza e politikës për zhvendosje, sipas Ted Downing (dhe realitetit në terren) merr përsipër të bëjë zhvendosje me faza, sa herë KEK-u të ketë nevojë për thëngjill (pra në thelb dokumenti politik për zhvendosje, vendos thëngjillin dhe jo qeniet njerëzore, duke ia kontestuar komponentin zhvillimor planeve dhe projekteve të Qeverisë, që thirren në nevojën për zhvillim ekonomik). Nuk mund të ketë zhvillim ekonomik duke rrënuar jetën dhe standardet ekonomike e sociale dhe duke shkaktuar konflikte civile dhe sociale në mes qytetarëve të një vendi.
- Sipas Bankës Botërore, raporti i dr. Ted Downing është përfshirë si dokumenti më i rëndësishëm mbështetës/orientues i Qeverisë në hartimin e ESIA (vlerësimi i impaktit mjedisor dhe social).

- Korniza ligjore për zhvendosje, ka një numër mangësish, që shkaktojnë probleme të mëdha, jo vetëm për këta banorë, por dhe për gjeneratat që do të vijnë më pas, duke ulur kështu në nivele të larta standardin e jetesës së qytetarëve të Hades, Shkabaj dhe Obiliqit, duke rritur nivelin e varfërisë për brezat pasardhës.
- Korniza ligjore për zhvendosje ka mbivlerësuar kapacitetin institucional të Qeverisë për të implementuar projekte kaq komplekse.
- Përgatitja për zhvendosje nuk ka përvijuar projektin me objektivat kryesorë të politikave ndërkombëtare, për të siguruar që risistemimi jovullnetar të jetë një projekt zhvillimor, me rikthim të standardit jetësor, ndarje të përfitimeve, konsultim dhe pjesëmarrje domethënëse. Përkundrazi, ka sjellë varfëri më të madhe.
- Mungesa e fokusit mbi objektivat primare dhe shpenzimet e risistemimit jovullnetar, janë nënvlerësuar dhe kalkuluar gabimisht, duke rritur kështu koston e investimit dhe kështu duke vonuar fazën e profitabilitetit për banorët e afektuar prej caktimit të zonës, si zone me interes të veçantë ekonomik.
- Struktura e paqartë e financimit të projektit (në rast të ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”), gjithashtu shkakton mangësi, rreziqe politike për Qeverinë, të cilat nëse zënë vend, do të përkeqësojnë pakënaqësinë ekzistuese civile dhe pakënaqësitë politike. Shpenzimet, të cilat tejkalojnë shpenzimet e risistemimit, do të paguhet nga çmimi i rritur i energjisë elektrike dhe jo nga Qeveria apo koncesionari privat, gjë që çon drejt konflikteve të ardhshme në mes të paguesve të rrymës dhe personave të zhvendosur.
- Së fundmi, pas miliona dollarëve të shpenzuar në asistencë teknike, kjo analizë tregon se korniza e propozuar e politikave për zhvendosje është paksa e maskuar, pra e paqartë, kurse plani për kompensim të parasë së gatshme, pothuajse plotësisht ndjek strukturën e dështuar të kompanisë pararendëse të mihjes, që ishte pronë e Qeverisë.

Në përmbledhje, Menaxhmenti i Bankës Botërore dhe Qeveria janë përgjegjës për ndërtimin e një strukture të paqëndrueshme të sigurisë, e cila do të shkaktojë vonesa dhe do të shtojë shpenzimet për çfarëdo zhvendosje. Këto vendime të Bankës Botërore, në bashkëpunim me Qeverinë, kanë rritur e jo zvogëluar rreziqet financiare, mjedisore, sociale dhe shëndetësore për kosovarët, për institucionet shtetërore, investitorët dhe më së shumti kanë rrezikuar personat që zhvendosen dhunshëm.

**Ragip Grajçevci, banor i fshatit Hade**, tha se nga viti 2004, jemi shpallur zonë me interes të veçantë ekonomik dhe ne e kemi pranuar këtë, mirëpo deri më sot jemi trajtuar në mënyrën më të keqe të mundshme nga Qeveria, MMPH-ja, KEK-u dhe Komuna. Pra, edhe pse kemi dërguar kërkesa e ankesa, kurrë nuk kemi marrë përgjigje. Këtu bëhet fjalë për një pjesë të fshatit Hade, e mbetur dhe jo për pjesën tjetër ku është bërë projekti. Nuk kemi kushte të zhvillojmë jetë normale në Hade, sepse është vetëm 200 m afër nga operimi me ekskavator të rëndë, ku gërmohet 24 orë dhe jemi të ndikuar nga zhurma, tymi, pluhuri djegia e qymyrit. Kemi mungesë të shkollës, sepse kemi 46 nxënës dhe nuk kemi transport publik. Problem është edhe papunësia. Tokën bujqësore na kanë marrë, nuk kemi të drejtë të ngremë një fermë apo serë, sepse nuk lëshojnë leje në komunë. Pra, tokën e bukës na kanë marrë, vetëm edhe 52 hektarë që kanë mbetur në Hade, tha se nuk jemi dakord për t’i dhënë, derisa të bëjmë një marrëveshje me KEK-un, Komunën dhe Qeverinë. Në fund, kërkoi që nga ky takim të dihet data e dislokimit të fshatit Hade.

**Xhafer Gashi**, u pajtua se problemet qëndrojnë, ashtu siç u përmendën nga parafolësit dhe vazhdoi se gjendja në Komunën e Obiliqit është shumë e rëndë dhe theksoi se në një

raport nga OBSH-ja, më 2015 tregon se 30% më shumë janë të prekur me sëmundje të kancerit në këtë komunë, sesa në nivel të Kosovës. Ka probleme të shumta me infrastrukturë, me operatorin KEK, që janë shumë të papërgjegjshëm në infrastrukturë, përmirësim të ambientit. Është filluar të ndërtohet lagjja e re e Hades dhe projekti është për mrekulli, por fatkeqësisht nëse dalim e shohim është në gjendje të tmerrshme, sepse ajo nuk ka infrastrukturë të mjaftueshme, shkollë, çerdhe, varreza, etj. Ka njerëz që jetojnë në zonën e KEK-ut, që jetojnë në gjendje të mjerueshme. Zhvendosja nuk ka planifikim afatgjatë dhe strategji të mirëfilltë nga MMPH-ja dhe kemi kërkuar të bëjmë një strategji të përbashkët dhe qytetarët të kenë një orientim për mundësitë e veta për jetesë. Edhe pas raportit të OBSH-së, nuk ka ndërhyrje të institucioneve qendrore. Po ashtu, raporti i Institutit Hidrometeorologjik, i thirrur për të bërë matjet, në nëntor dalin 22 tejkalime të vlerave të lejuara, në dhjetor 27 tejkalime të ndotjes së ambientit, janar 22 tejkalime e kështu me radhë, dhe me sa di, me ligj lejohen 35 tejkalime brenda vitit, për shkak të fillimit të punës. Duhet pasur parasysh, sidomos subvencionimin e studentëve, mundësinë e punësimit, ka lagje që asnjë të punësuar të ri nuk e ka, edhe pse nga ta janë pensionuar shumë. KEK-u, edhe pas shumë premtimeve, nuk ka bërë asgjë, sidomos në asfaltimin e rrugëve, pastaj 300 mijë euro të premtuara për ambient. Këta kanë obligime edhe sipas Rregullores së zhvillimit ekonomik, që bashkërisht me komunitetin, të bëjnë prioritetet që kanë të bëjnë me komunitetin, të cilën s'e bëjnë kurrë. KEK-u është i papërgjegjshëm, karshi këtyre dëmeve që u shkaktohen qytetarëve të Komunës së Obiliqit. Në fund, kërkoi që kjo temë të trajtohet si duhet dhe në mënyre urgjente, sepse qytetarët janë duke e vuajtur këtë gjendje.

**Shaip Muja**, tha se problemi është shumë-disiplinor dhe duhet të zgjidhet jo vetëm nga KEK-u ose Ministria, por nga të gjitha institucionet përgjegjëse. Në bazë të ligjit, për shkak të ndotjes së ajrit, ekspozimit ndaj zhurmës, rrezikshmërisë së rrëshqitjes së dheut, pra a lejohet kjo popullatë të jetojë në këto ambiente? A shkelen të drejtat e tyre? Pse zhvendosja nuk u bë deri më sot? Territori duhet të konservohet dhe banorët duhet të dislokohen sa më shpejt. Një shembull, një i ri nga kjo zonë, në vitin 2004 ishte 18 vjeç dhe tash ai është i martuar, ka krijuar familje dhe nuk ka ku të jetojë, prandaj kjo është përgjegjësi institucionale dhe shkelje e të drejtave të njeriut. Problemi tjetër është shtrirja e Kosovës së Re, për të cilën nuk e dimë as ne si deputetë ku do të zhvillohet, dhe se prapë këta banorë do të jenë të ekspozuar nga mihjet sipërfaqësore, zhurma, ndotja etj. Propozoj që të formojmë një nënkomision, në kuadër të komisionit, për të sqaruar a janë respektuar ligjet, udhëzimet dhe të vizitojë zonën.

**Arben Çitaku**, tha se javën e kaluar e kemi pasur një takim me qytetarët dhe kryetarin dhe i kemi trajtuar këto çështje. MMPH-ja, në vazhdimësi, ka qenë pjesë e zgjidhjes dhe adresimit të çështjeve, të cilat po ngrihen këtu.

Procesi i zhvendosjes, në kontekstin e planifikimit hapësinor, MMPH-ja e ka bërë planin hapësinor të fushës së mihjes së re, ku decidivisht përcaktohen zhvillimet në atë zonë, mundësitë të cilat i ofron dhe afatet kohore. Ky dokument është i miratuar në Kuvendin e Kosovës. Në kontekstin e mirëqenies së qytetarëve, pra banimit, gjithashtu MMPH-ja në bashkëpunim me Bankën Botërore e ka hartuar dokumentin “Korniza e politikave të zhvendosjes”, i cili është miratuar në Qeveri. Kjo i ka adresuar gati të gjitha këto sfida, bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe i ka definuar aktorët përgjegjës për zbatimin e tyre. Në pajtim me këtë, MMPH-ja e ka zgjidhur problemin e lagjes së re dhe i ka definuar hapat që duhet të punohet. Në kuadër të përgjegjësisë që kemi, ne jemi linja e dytë e cila

merret kryesisht me monitorimin e kornizës së politikave të zhvendosjes dhe kontrollit të ndërtimeve në atë pjesë. Në linjën e parë, sipas ligjeve, është operatori, në këtë rast KEK-u dhe në linjën e ndërtimeve është Komuna. Raporti i fundit i Bankës Botërore nga drejtori, z. Marko Mantovjeli, që është “Country manager”, në bazë të raportit për zhvendosjen e lagjes Shala, ata e kanë cilësuar kështu: *“Në përgjithësi, popullsia e zhvendosur të paktën e ka mbajtur, në mos përmirësuar kushtet e tyre të jetës në lidhje me parakushtet e zhvendosjes”*. Pra, në fazën kur ne e kemi zhvendosur lagjen Shala, të paktën nivelin e standardit të atyre qytetarëve e kemi ruajtur, nëse nuk kemi mundur të arrijmë përmirësime. Pra, ne kemi filluar së zbatuari kornizën e politikave të zhvendosjes, në atë kohë, sepse ka qenë fazë tranzitore dhe tani përgjegjës është KEK-u për zbatimin e kornizës së politikave të zhvendosjes. Nëse respektohen këta hapa, të gjitha sfidat e qytetarëve në masën më të mirë do të adresohen. Kjo është një zonë me interes nacional dhe si e tillë duhet të trajtohet.

**Agim Preniqi**, banor i fshatit Hade, tha se gjendja është kaotike dhe e rëndë dhe kjo bëhet nga organet tona dhe Qeveria jonë. Sipas tij, të rinjtë kanë mbetur pa u martuar, disa janë martuar e jetojnë në kushte të rënda. Në shkolla punohet me dy klasa me një, infrastruktura është tmerr. Është absurd se asnjë drejtor i KEK-ut nuk banon në Obiliq, por në Prishtinë dhe familjarët e tyre janë të punësuar shumica në KEK. Nëse dikush ka një pikë nder në këto institucione, duhet të marrin një vendim dhe është koha e fundit që atyre qytetarëve t’ju dilet në ndihmë. Ne jemi bërë si një laborator, ku ka sëmundje të ndryshme, sepse askush nuk po merret me ne.

**Arben Gjukaj**, tha se KEK-u është ndërmarrje publike dhe menaxhohet në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike, dhe në bazë të kësaj, i kryen të gjitha raportimet. Unë bashkë-ndjej dhe bashkëjetoj me qytetarët e Komunës së Obiliqit, sepse 60% të jetës sime e kaloj aty që tri vjet. KEK-u operon që nga viti 1962 dhe për lëndë të parë djegëse ka vetëm qymyrin. Deri në vitin 2010 ka marrë qymyr nga tri pika, ndërsa nga shtatori i 2010 koncentrohet vetëm në një pikë-Sibovci, jugperëndim, projekt i cili është aprovuar më 2006. Në bazë të kësaj, menaxhmenti i KEK-ut, me monitorim nga Komisioni për Miniera dhe Minerale (KPM), i kryen operimet e veta. Kjo hapësirë ka rezerva afro 123 milionë tonelata qymyr, të cilat janë të mjaftueshme të furnizojmë dy termocentrale deri në vitin 2024. Në vitin 2004, KEK-u nuk është menaxhuar nga vendorët, por nga një menaxhment ndërkombëtar, nën përgjegjësinë e Agjencisë së Mirëbesimit dhe ka bërë një zhvendosje, për arsye të sigurisë, ka pasur lëvizje të tokës, kryesisht në një pjesë të fshatit Hade. Në vitin 2009, është bërë një zhvendosje, nga KEK-u, së bashku me Ministrinë dhe është aplikuar Ligji për shpronësim. Ne kemi qenë kërkuesit, ndërsa të gjitha procedurat janë udhëhequr nga MMPH-ja. Është duke u zhvilluar një projekt shumë ambicioz për ndërtimin e Kosovës së Re, dhe në maket të Kosovës së Re, deri në vitin 2013, ka qenë e paraparë edhe miniera, ndërsa në korrik 2014, minierat kanë mbetur aset shtetëror.

Për ambientin u fol në mënyrë jo objektive dhe KEK-u nuk është ndotësi i vetëm, sepse këtu operojnë edhe ndotës më të rrezikshëm. Një deponi disa hektarësh afër “Sherif Petrol”, ku deponohen materie të rrezikshme radioaktive, pastaj është edhe depoja rajonale, që është jashtë kompetencave të KEK-ut.

Të gjitha organizatat ndërkombëtare, KEK-un e kanë identifikuar me katër ndotës kryesorë:

1. Deponia e trashëguar e Hirit, e trashëguar nga viti 1962.
2. Fenolët dhe mbetjet tjera të trashëguara nga paraluftra.

3. Transporti i thëngjillit me shirita i hapur.

4. Tymtarët, emetimi i gazrave dhe i tymit.

Të gjitha këta ndotës janë të mbyllur. Kosova A, më herët ka pasur ndotje 1100 mg, e tash e kemi sjellë në 50 mg, 98% e deponisë së hirit është mbyllur, 250 mijë fidanë janë mbjellë, transporti hidraulik është bërë dhe fenolët tashmë janë eksportuar jashtë vendit. Ne e kemi përkrahur Ligjin për Obiliqin, sepse i paguajmë Ministrisë së Financave shumë 27 milionë euro, në emër të taniemës. Në kuadër të obligimeve që kryejmë ndaj komunitetit, për dy vitet e fundit, i kemi kryer rreth 1 milion euro investime Komunes së Obiliqit .

**Hilmi Jashari**, theksoi se institucioni ynë ka hapur një hetim për ndotjen e ambientit në këtë komunë dhe efektin që ka lidhur me realizimin e të drejtave qytetare dhe raporti gjatë javës së ardhshme do të jetë i gatshëm. Zona është shpallur me interes nacional, mirëpo trajtimin nuk e ka të tillë dhe efekti i ndotjes së ambientit nuk prek vetëm banorët e Komunes së Obiliqit, por gjithsecilin. Sa për ilustrim, ajo zonë njihet edhe për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, një prej tyre është patatja, që është një prej artikujve me konsum në tërë Kosovën. Një shembull që kam pasur rast të shoh gjatë vizitës, një familje që jeton afër KEK-ut, para qasjes në shtëpi ka një pengesë sigurie dhe përditë duhet të kalojë përmes kësaj pike kontrolli. Në shtëpi i ka dy fëmijë të moshës së re, të cilët janë të sëmurë prej astmës, prandaj vetëm fati i këtyre dy fëmijëve e meriton vëmendjen, jo vetëm të këtij Komisioni, por edhe gjithë Kuvendit të Kosovës, për të debatuar se cilat janë zgjidhjet.

Nëse nga viti 2004 e deri më tani, ka vazhduar ky problem. Pajtohem se është problem shumë më kompleks, duke filluar prej të drejtës në jetë – shembulli i dy fëmijëve, kemi probleme me mbrojtjen e të drejtës private dhe familjare, e garantuar me Kushtetutë, kemi probleme me trajtimin e barabartë që ka të bëjë me mos diskriminimin. Prandaj, kjo e tejkalon fuqinë e një resori qeveritar dhe një operatori ekonomik, për ta zgjidhur këtë problem dhe mendoj se ka tejkaluar edhe fuqinë e një qeverie, për ta zgjidhur këtë problem, prandaj forumi më i përshtatshëm për të diskutuar dhe për të ofruar zgjidhje, është Kuvendi i Republikës së Kosovës.

**Salih Salihu**, tha se është përgjegjësi e Qeverisë kjo që bëhet me banorët e Hades, edhe kryetari i Komunes, së bashku me qytetarët duhet të organizojnë një protestë për këtë, sepse është në pyetje jeta dhe mirëqenia e njerëzve. Ne, si Komision, fillimisht duhet ta formojmë një grup të punës, ta vizitojmë Haden dhe pastaj ta ngremë në Kuvend këtë çështje.

**Adem Salihaj**, theksoi se Komisioni, për herë të parë njoftohet me këtë problem, sot. Pra, kërkohet një datë e zhvendosjes së banorëve të Hades, që kanë mbetur aty dhe sot nuk e kemi një përgjigje nga KEK-u, që thanë se deri më 2024 do të bëhet një studim fizibiliteti, po ashtu edhe nga MMPH-ja nuk ka përgjigje. Prandaj, banorëve që u është marrë toka, si mund do të jetojnë deri më 2024, është problem serioz dhe u pamundësohet ndërtimi aty ku janë dhe atje ku është paraparë zhvendosja. Komisioni do të merret me këtë çështje, por së pari të furnizohet me letra nga banorët, KEK-u, Ministria. Pasi t'i marrë Komisioni këto informata, mund t'i rekomandojë Kuvendit një zgjidhje.

**Murat Hoxha**, theksoi se në 2004 kam qenë pjesë e hartimit të elaboratit të eksproprijimit të fshatit Hade, pas matjeve në mënyrë gjeodezike, në bazë të matjeve është konstatuar se ka lëvizje të vogla. Për shkak se ka qenë urgjente, në bazë të elaboratit

të eksproprijimit, në atë kohë, është formuar një komision, i cili ka projektuar objekte të përkohshme, për t'i zhvendosur banorët e Hades, derisa të ndërtohet lagjja e re.

Nga pjesëmarrësit, sidomos banorët e Hades, shtruan edhe një varg pyetjesh, për të cilat u diskutua, si p.sh: përgjegjësia e kujt është tani, e MMPH-së apo e KEK-ut për lagjen e re, Hadja në Shkabaj? A ka KEK-u plan dinamik për zhvendosjen e Hades dhe për MMPH-në sqarim për shndërrimin e pronës bujqësore në ndërtimore? A lejohet sot ndërtimi në Haden e vjetër ose në të renë?

**Kryesuesja Duda Balje**, falënderoi pjesëmarrësit në takim dhe tha se përmes Kuvendit do të konkretizojë hapat e veprimit. Së bashku me Komisionin, e marrim obligim që të dalim në terren dhe të shohim gjendjen, si dhe do të caktojmë edhe një takim në mes KEK-ut, MMPH-së, Komunës dhe banorëve.

#### **4. Shqyrtimi i sëmundjes së shfaqur tek shtazët – sëmundja gungore e gjedhëve**

Kryesuesja falënderoi për prezencën e kryeshefit të AUV-së, **Valdet Gjinovci**, të cilin e ftoi të marrë fjalën rreth problematikës për të cilin është ftuar. Po ashtu, falënderoi dhe njoftoi fillimisht se kjo sëmundje nuk rrezikon shëndetin publik. Sëmundja gungore e lëkurës (SGL), vazhdoi, e njohur si “Lumpy Skin Diseases” (LSD), është sëmundje e një rëndësie të lartë socio-ekonomike. Është sëmundje virale e gjedhit, me karakteristike tipike e gungave në lëkurë. Nga kjo sëmundje mund të preken më shumë se 50 % e fermave blegtorale, me një ngordhje më tepër se 10% e kafshëve të prekura. Humbjet tjera janë reduktim i prodhimtarisë së qumështit, ulje e fertilitetit dhe dëmtimi i përhershëm i lëkurës. Bartës të kësaj sëmundje janë insektet pickuese, që më aktive janë në periudhën e pranverës së vonshme, verës dhe vjeshtës së hershme.

Deri këtë vit, kjo sëmundje nuk ka qenë e përhapur në vendet e rajonit ballkanik dhe vendi ynë ka qenë i lirë nga kjo sëmundje. Në vitin 2015, është paraqitur për herë të parë në Greqi, ndërsa nga prilli i këtij viti kemi pasur rastet e para të kësaj sëmundjeje në Bullgari, e cila për një kohë të shkurtër, brenda muajit prill, ka arritur një përhapje të shpejtë, me ç’ rast ka arritur në Maqedoni, Serbi, Shqipëri, Mal të Zi dhe në Kosovë. Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë, duke u bazuar në raportet e shpërthimit të sëmundjes në këto shtete, ka marrë vendim për ndalimin e importit të kafshëve të gjalla.

Prandaj, duke qenë se jemi të ekspozuar ndaj një rreziku të lartë të paraqitjes së kësaj sëmundjeje në vendin tonë, më poshtë janë paraqitur pikat kryesore për mbrojtjen nga kjo sëmundje:

1. Në qoftë se vetëm 10% e fermave blegtorale do të preken, kostoja në vend do të jetë mbi 1,000,000 EUR. Nëse nuk do të ndërmarrim masa për kontrollin e sëmundjes, do të kemi një përqindje më e lartë e fermave (kopeve) të prekura dhe ndikim negativ me të lartë në vend.
2. Kemi dy opsione për kontroll: asgjësimi / kompensimi dhe vaksinimi i gjedheve.
3. Në nivelet aktuale të kompensimit, kostoja do të jetë 1,000,000 EUR për asgjësimin e vetëm 700 krerëve, afërsisht. Ka pak gjasa, që therja e një numri kaq të vogël të kafshëve do të arrijë nivel të konsiderueshëm të kontrollit të kësaj sëmundjeje. Një politikë e tillë e luftimit do të jetë e shtrenjtë dhe pa efekt.

4. Vende të tilla si Greqia, Bullgaria dhe Maqedonia fillimisht janë përpjekur për të kontrolluar sëmundjen përmes asgjësimit dhe kompensimit, por kanë dështuar të gjithë dhe tani janë duke aplikuar vaksinimin e gjedhit si masë mbrojtëse.
5. Sëmundja lëviz në një seri distancash të gjata duke përjashtuar idenë e një përhapje të ngadaltë. Buffer vaksinimi (vaksinimi zonal, kufitar) nuk ka funksionuar, çka kërkohej një vaksinim masiv i të gjithë popullatës së gjedhit në vend.
6. Sëmundja është e përhapur në gjithë rajonin e Ballkanit, tani edhe në vendin tonë.
7. Nëse ne dëshirojmë të kufizojmë humbjet, duhet të shkojmë me metodën vaksinimit masiv, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të mbulojmë, përfshijmë të gjithë vendin.
8. Një vlerësim, analizë (Cost-Benefit), ka treguar se edhe në nivele të ulëta të kësaj sëmundjeje, nëse nuk do të aplikohet vaksinimi, humbjet do të jenë të larta.
9. Kjo sëmundje nga kafshët shtëpiake prek vetëm gjedhët, jo speciet tjera dhe nuk paraqet rrezik për njeriun (shëndetin publik).

Në muajin prill të vitit 2016, nga projekti i Komisionit Evropian, Asistenca Teknike për Drejtorinë e Shëndetit, Mirëqenies së Kafshëve dhe Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë, është organizuar Works hop me praktikantë private veterinarë, të kontraktuar nga AUV, nga të gjitha komunat e Kosovës, ku është diskutuar mbi rrezikun e paraqitjes së sëmundjes së SGL, shenjat klinike, diagnostikimi, masat të cilat duhet ndërmarrë dhe këshillat që duhet dhënë fermerëve të vendit.

Është publikuar dhe botuar manuali mbi sëmundjen gungore të lëkurës (SGL), i cili u është shpërndarë veterinerëve të kontraktuar nga AUV.

Gjatë muajit maj, nga ekspertët e projektit të KE-së, është bërë vlerësimi paraprak, analiza ekonomike e kontrollit të sëmundjes gungore të lëkurës dhe implikimet e saj.

Në muajin qershor 2016, më 8.6.2016, është dërguar kërkesa në drejtim të Zyrës së BE-së në Kosovë, për mbështetje në sasi prej 265,000 dozash të vaksinave.

Më datë 9.6.2016, është dërguar njoftimi në Qeveri lidhur me situatën epidemiologjike të sëmundjes, (SGL), si dhe koston buxhetore- financiare.

Në muajin qershor, më 15.6.2016, është dërguar kërkesa në drejtim të Zyrës së KE-së, Bruksel, kërkesa për mbështetje me vaksina në drejtim të z. Morten Jung D.3 (Regional cooperation and programmes).

Po në muajin qershor, më **24.6.2016**, është dërguar kërkesa për mbështetje me vaksina, në drejtim të Zyrës së BE-së, në Bruksel, drejtorit të Menaxhimit të Krizave për ushqim, shëndet të kafshëve dhe bimëve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Shëndet dhe Siguri të Ushqimit në Komisionin Evropian.

**Më datë 24.6.2016**, është marrë vendimi për ndalimin e tregjeve të kafshëve, vendim i cili u është dërguar komunave të Kosovës.

Në muajin korrik, më datë **15.7.2016**, është dërguar kërkesa në drejtim të Zyrës së BE-së, Bruksel, drejtorit të Menaxhimit të Krizave për ushqim, shëndet të kafshëve dhe bimëve, Drejtorisë së Përgjithshme për Shëndet dhe Siguri të Ushqimit, në Komisionin Evropian.

Më datë 23.5.2016, është mbajtur takim në Bruksel me dr. Bernard Van Goethem, drejtor i Menaxhimit të Krizave për ushqim, shëndet të kafshëve dhe bimëve, pranë Drejtorisë së



Përgjithshme për Shëndet dhe Siguri të Ushqimit në Komision Evropian, i cila ka premtuar mbështetje në sasi prej 50.000 dozave, ku nga kjo sasi, 25,000 doza janë dhuruar dhe u janë shpërndarë veterinerëve në terren.

Rasti i parë i kësaj sëmundjeje është paraqitur më 21.6.2016 në fshatin Zhujë, Komuna e Kamenicës.

Më datë 23.6.2016, është konfirmuar nga laboratorit referent në Sofje, Bullgari.

Më datë 1.7.2016, është realizuar furnizimi me 25,000 doza vaksinë nga Komisioni Evropian.

Më datë 1.8.2016, është mbajtur takimi me kryetarët e komunave të Kosovës, nën organizimin e MAPL-së, nga ku është rekomanduar që sëmundja gungore e lëkurës të shpallet sëmundje, si incident me karakter kombëtar, ngritjen e grupit ndër-institucional për menaxhimin e incidenteve - GNMI dhe aktivizimin e planit të reagimit kombëtar.

Më datë 3.8.2016, është dërguar propozimi që sëmundja gungore e lëkurës të shpallet sëmundje si incident me karakter kombëtar, ngritjen e grupit ndër-institucional për menaxhimin e incidenteve - GNMI dhe aktivizimin e planit të reagimit kombëtar.

Numri i kafshëve me shenja klinike është 618 krerë, ndërsa numri i kafshëve të ngordhura 185.

**Kryesuesja** falënderoi dhe parashtrroi pyetje, ku u interesua për vaksinimin se si do të bëhet, ngase sipas informatave që disponon, nëse nuk jepet vakcina në kohën e caktuar, ekziston rreziku i ngordhjes së vazhdueshme të gjedhëve, por kryeshefi tha se nuk ka nevojë për këtë brengë, sepse janë marrë masat për këtë përkujdesje dhe njoftoi se sot apo nesër, do të arrijnë vaksinat nga Afrika e Jugut, i cili vend është i vetmi që prodhon këto vakcina. Gjithashtu, ai njoftoi edhe për pyetjen që është aktuale vaksinimit dhe tha se mishi lejohet për përdorim, pas vaksinimit.

**Salih Salihu**, konstatoi dështimin e Qeverisë rreth përhapjes së kësaj sëmundjeje, ngase nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura, sidomos edhe për faktin që kafsha, nëse nuk asgjësohet, do të jetë burim i infeksionit, madje edhe më tepër sesa vetë virusi i shfaqur. Lidhur me përhapjen, përkatësisht “mizën”, përveç deputetit Salihu, kishte debat polemizues me kryeshefin edhe deputeti **Shaip Muja**, sidomos rreth pyetjes ku dërgohen kafshët e ngordhura, si dhe **Adem Salihaj**, i cili parashtrroi disa pyetje: Vakcina do të jetë parandaluese apo diçka tjetër? A duhet fermeri (i paarsimuar në këtë drejtim) të konstatojë infeksionin apo dikush tjetër? Sa posedon kapacitete AUV, që të ballafaqohet me këtë problematikë, a mund të konstatohet infektimi përmes analizës së gjakut dhe sa kushton një vakcinë? Kryeshefi, përkundër mungesave të theksuara në kapacitetet tona, garantoj se AUV, por edhe nivelet komunale që duhet të bëjnë asgjësimin e gjedheve të ngordhura, do të mund të ballafaqohen me këtë sëmundje, ngase mundësi laboratorike nëse nuk ka vendi ynë, së paku ka mundësi me aparaturë teknike. **Salih Salihu**, pyeti për mundësinë e djegësës së kafshës së ngordhur, të cilin kompleks Kosova sipas kryeshefit nuk e ka, por niveli lokal është ai që duhet të përkujdeset për këtë çështje. **Adem Salihaj**, pyeti lidhur me raportimin e komunave për asgjësimin e këtyre mbeturinave të rrezikshme dhe apeloj që AUV, maksimalisht të jetë e kujdesshme në këtë drejtim, ngase AUV, sipas tij, e ka përgjegjësinë më të madhe dhe nuk mjafton të konstatohet “na ndodhi kjo fatkeqësi” ose “nuk kemi ditur”, sepse për këtë arsye themelohen organet me plane afatgjate dhe urgjente për momente të ndryshme, sikurse kjo sëmundje. Sipas tij, situata më e rëndë ende është duke ardhur, duke u krijuar burime të reja të infeksionit.

Keni pasur mundësi të ndërmerri masa parandaluese, pasi problemi ka filluar në Turqi, Greqi, Maqedoni etj., tha ai, kurse **Emilija Rexhepi** kërkoi ndihmë nga AUV rreth komunës Restelicë, me të cilën janë shumë të pakta lidhjet e bashkëpunimit, sidomos për këtë sëmundje. **Murat Hoxha** pyeti se sa ka rrezik për mishin që përdor popullata, kurse përgjigjja ishte se inspektorati gjendet në çdo hap. **Kryesuesja** pyeti për kompensim, për çka kryeshefi tha se buxheti është tepër i limituar, ndërkaq ajo apeloi që së paku në kufi, të bëhet spërkatja si masë sigurie.

## **5.Të ndryshme**

**Kryesuesja** njoftoi Komisionin se gjatë javës që vjen, të hënën, Komisioni do të vizitojë Haden, kur do të vendoset edhe për caktimin e datës së intervistimit të kandidatëve për zëvendës drejtor dhe kryesues të Komisionit Shqyrtues në ARRU.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,  
**Duda Balje**